

VENDIM Nr. 192, datë 2.4.2014 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 48, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË NË VËSHTIRËSI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli I Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”, zëvendësohen përkatësisht me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

2. Pika 1 riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Përfitues të këtij programi janë punëkërkuesit e papunë në vështirësi, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi. Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.

Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

b) Punëmarrësin e përfshirë në këtë program, deri në katër paga, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e pestë e të gjashtë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program:

i) deri në 100 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë deri në 50 punonjës;

ii) deri në 50 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë mbi 50 punonjës.”

3. Në fund të pikës 5, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.”

4. Në pikën 6 hiqen fjalët “... verifikuar nga Inspektorati i Punës ...”.

5. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjat “a” dhe “d”, pas fjalës “... juridik ...” shtohen “... dhe fizik ...”.

b) Pas nënndarjes “v” të shkronjës “dh”, shtohet nënndarja “vi” me këtë përmbajtje:

“vi) akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore.”

6. Pika 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.”

7. Në paragrafin e dytë të pikës 12, pas fjalës “... organizimit ...” shtohen fjalët “... vlerësimit të projekteve ...”.

8. Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.”

9. Në pikën 14 hiqen fjalët “... për një periudhë të paktën tremujore ...”.

10. Në paragrafin e dytë të pikës 16, hiqen fjalët “... në bashkëpunim me inspektoratin rajonal/vendor të punës ...”.

11. Paragrafi i parë i pikës 17, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në rastet kur punëkërkuesi, si punëmarrës, pjesëmarrës në këtë program, largohet përpara afatit të përcaktuar në kontratë, për shkaqe të arsyeshme, zëvendësimi bëhet nga zyra përkatëse e regjistrimit pas njoftimit nga punëdhënësi.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama